



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Albe Group” Sh.P.K. të datës 22.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 14.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e Kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Albe Group” Sh.P.K. të datës 22.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 14.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e Kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Albe Group” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Albe Group” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 22.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 14.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e Kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

- *“Kerkesa jone per ndryshim i perket kryesisht nenit 9.1 dhe 9.2 te kerkesave te tenderit. Rregullorja aktuale thote se "Te gjitha automjetet e ofruara (shasite) duhet te prodhohen nga i njejti prodhues". Ne propozojme nje ndryshim te kesaj kerkesa per te lejuar operatoret ekonomike, perfshire kompanine tone, te aplikojne me marka te ndryshme te prodhuesve te shasive pasi qe edhe kerkesa eshte per dy shasi te ndrryshme dhe jo te gjitha prodhuesit i prodhojne shasite e ndryshme me te njejtin brand, kjo dukuri e ngjajshme mund te verehet edhe te prodhimi i automjeteve pa dashur te permendim emrat e brendeve, ku kompania kryesore i ka brendet e ndara per ato makina komerciale dhe ato luksoze.*

Me e rendesishmja, ne pohojme se megjithese emrat e markave mund te ndryshojne, te gjitha pjeset e prodhimit te shasise do te mbeten te njejta nga i njejti prodhues. Ky amendament i propozuar nga ana jone synon qe te mundesohet barazia ne trajtimin e njejte dhe jo diskriminues ndaj gjithe operatoreve ekonomik qe jane te interesuar te marrin pjese ne kete procedure te prokurimit dhe duke i lejuar operatoret ekonomike te zgjedhin markat e shasise qe i pershtaten me mire nevojave dhe kerkesave specifike te projektit duke ruajtur aspektin kritik te konsistences ne prodhimin e pjeseve. Ky ndryshim potencialisht mund te çoje ne nje game me te larmishme dhe me te fuqishme ofertash, nga e cila perfundimisht do te perfitoje Komuna e Prishtines. Kerkesat aktuale te tenderit specifikojne qe te gjitha automjetet e ofruara (shasia) duhet te prodhohen nga i njejti prodhues. Ne e njohim qellimin qe qendron pas kesaj dispozite; megjithate, ne propozojme kete ndryshim ne keto dy pika: Projekti te ndahet ne dy lote: Ne kete skenar, tenderi mund te ndahet ne dy lote te veçanta, nje per çdo lloj shasie te kerkuar. Kjo ndarje do t'u mundesonte operatoreve ekonomik te specializohen ne nje lloj shasie te veçante, duke çuar potencialisht ne çmime me konkurruese dhe oferta me cilesi me te larte. OSE Te ndrryshohet kerkesa aktuale qe eshte permendur me larte”.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit me datë 23.08.2023 ka kërkuar nga njësia kërkuese që të bëj vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore me paralajmërimin si në vijim: *“Ju lutem që të shqyrtoni me kujdes kërkesën sepse është kërkesa e dytë me radhë me pretendime të njëjta dhe ju lutem të dërgoni komentet e juaja të cilat nevojiten për të përgjigjen parashtruesit. Në rast se kërkesat e vendosura nga ju mund të janë diskriminuese/favorizuese dhe mund të bien ndesh me LPP apo aktet tjera nënligjore atëherë ju e mbani përgjegjësin nëse do të kemi ankesa në OSHP dhe si rezultat mund të kemi edhe vonesa në realizimin e projektit”.*

Rrjedhimisht me datë 23.08.2023 njësia kërkuese ka dërguar përgjigjen si në vijim: *“Sqarim: Ne kemi kërkuar që shasitë të jenë të të njëjtit prodhues i cili ofrohet nga OE që do të thotë shasia me 16m³ duhet të jetë i të njëjtit prodhues kurse shasia e 8m³ mund të jetë i njëjtit prodhues ose prodhues tjetër sipas specifikimeve teknike të ofruara. Vërejtje: Nëse ofroni shasi me 8m³ të gjitha duhet të jenë të një prodhuesi që ofroni. Nëse ofroni shasi me 16m³ të gjitha duhet të jenë të një prodhuesi që ofroni”.*

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.